



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 101, datë 12.10.2020

**PËR DHËNIE TITULLI “QYTETAR NDERI” Z.VANGJEL TOÇI**

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 ”Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1.1, gërma “b” dhe pika 1.7, gërma “a”; neni 54, pika m, Ligjit nr.112/2013, datë 04.04.2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” neni 14, neni 15, pika 1/a, neni 16, pika 1, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e Komisioneve Këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 241, datë 14.01.2015 “Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit këshillimor dhe dhënien e titujve vendorë të nderit pranë Bashkisë Durrës”, Urdhërit nr.313, datë 06.10.2020, nga Zëvendëskryetarja e Bashkisë “Për ndryshimin e përbërjes së komisionit këshillimor për dhënen e titujve vendorë të nderit pranë Bashkisë Durrës për vitin 2020”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga komisioni këshillimor për dhënien e titujve vendorë të nderit, me propozim të paraqitur nga Qendra Muzeore Durrës me shkresë nr.419 prot., datë 03.09.2020, me drejtor z.Alban Ramohitaj njëkohësisht dhe anëtar i Këshillit Bashkiak,

**KËSHILLI BASHKIAK  
V E N D O S I :**

1. T’i japë titullin “Qytetar Nderi” arkeologut prof. Vangjel Toçi,

me këtë motivacion:

*“Për kontributin e rëndësishëm që ka dhënë në krijimin dhe drejtimin e institucioneve të kulturës dhe trashëgimisë historike në qytet, për zbulimin e Anfiteatrit Antik dhe dhjetëra monumente dhe objekte arkeologjike, të cilat e bënë*

*Durrësin të njohur në nivel ndërkombëtar, duke e kthyer arkeologun Vangjel Toçi në simbol të lashtësisë së Durrësit 3000 - vjeçar”*

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli Bashkiak, Kryetari i Bashkisë Durrës dhe Komisioni Këshillimor për dhënen e titujve vendorë të nderit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

B-REPUB

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 12.10.2020**




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 934 / prot.

Durrës, më 12 / 10 .2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK ✓

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.101 datë 12.10.2020 Për dhënie titulli “Qytetar Nderi” z. Vangjel Toçi.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që më jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

